



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 549/2 prot

Datë 15.03.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-52638-12-09-2022, me objekt: “*Shërbim i printimit dhe zarfimit të faturave për nevoja të SHRUKD*”, me fond limit 24.445.440 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.02.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues: Operatori ekonomik “Inpress” SHPK
Ish Blloku i Magazinave të Tregtisë, Rruga “Siri Kodra”,
Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A
Lagja 17, Rruga “Dalip Peza”, Durrës

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “Adel CO” SHPK
Rruga “Muhamet Gjollështa”, tek Zogu i Zi, Tiranë

Në datën 13.03.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/2954, si dhe nr. protokollit 549/2023 datë 13.03.2023 e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-52638-12-09-2022, me objekt: “*Shërbim i printimit dhe zarfimit të faturave për nevoja të*

SHRUKD”, me fond limit 24.445.440 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.02.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK.

Konkretisht operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK është skualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

OE nuk permbush:

1.Kapaciteti teknik pika 2.3.8 / pasi;

Kartela teknike për makinerinë me Faturë Nr.282/22 “Makineri Pajisje Dixhitale Ricoh Pro C901S”, nuk ka emër dhe firmë përkthuesi, por vetem e noterizuar.

Kartelat teknike të paraqitura për makinerinë sipas faturës Nr.904/22 “Printer Ricoh 8110”, nuk janë për këtë pajisje por për Ricoh Pro 8110EX dhe 8110S.

Nuk ka paraqitur kartele teknike për makinerinë sipas faturës: Nr.282/22 “Pajisje Zarfimi Pitney Boëes DI 350”.

2. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim / pasi: pesha e mostrës së letrës nuk është sipas specifikimeve të kërkuara, kjo referuar analizes së kryer në një Laborator Testimi të njëjës prej mostrave, ku konstatohet se pesha e letrës është më e vogël se 90 g/m2.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK pjesmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushjen kritereve si më poshtë vijon:

2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori ekonomik duhet të paraqesë 10 (copë) fatura sipas të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara ne dst, ne datën dhe orën e caktuar si afat i fundit per dorezimin dhe hapjen e ofertave.

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Printimi i faturës dhe palosje në versionin "Selfmailer"

Formati: A4

Letra: LaserBond 90gsm

Fatura duhet të zarfohet në formën "selfmailer" me perforim dhe të paloset në formën "C"

Ngjyra:

Letra e paraprintuar (Logo kryesore në të dyja krahet e faturës si dhe reklama në pjesën e mbrapme) të jetë me ngjyra dhe të dhënat e tjera. Imazhi i letrës mund të ndryshojë çdo tre (3) muaj.

Gjithashtu shuma debitore dhe teksti që e shoqeron si dhe fjala "Debitor" duhet të jetë me ngjyrë të kuqe (për klientët debitorë).

Të dhënat e tjera të faturës me ngjyrë të zezë.

Fatura duhet të ketë dy linja perforimi përgjatë gjatësisë së faturës për hapjen e zarfit si edhe instruksionet përkatëse për hapjen e zarfit. Ngjitje nga krahet anësore. Perforim horizontal tek linja e treguar. Cdo faturë, në pjesën anësore mbrapa duhet të ketë numrin serial të lotit të fileve, zonën dhe numeratorin për zonë.

Bashkëngjitur edhe një simulim se si duhet fatura (debitore).

2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.8 *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*

- 3 (tre) makineri dixhitale (2 për prodhim normal dhe 1 për rezervë në rast difekti). Të paktën 2 nga makineritë duhet të jenë me ngjyra. Disponimi i makinerikeve duhet vërtetuar me faturë blerje ose dokument zhdoganimi ose cdo formë tjetër disponimi që njihet Kodi Civil i RSH. Edhe në rastin e marrjes me qera nga kompani tjetër, duhet paraqitur kontrata qirasë e vlefshme bashkëngjitur fatura e blerjes, ose cdo formë tjetër disponimi që njihet Kodi Civil i RSH*
- Operatori duhet të paraqesë kartelën teknike të makinerive nga të cilat duhet të rezultojnë se makineritë kanë një kapacitetjo me pak se prej jo më pak se 1041 fletë A4/ore të printuara nga të dyja anët.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën, ne kopje origjinale ose te noterizuara, përpara

publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 15.03.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri